



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E BRENDSHME
SHOQËRIA “ILLYRIAN GUARD” SH.A.
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. _____ Prot

Tiranë më _____._____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Automjesh ” Për nevojat e Shoqërisë Illyrian Guard SH.A

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

34100000-8-Automjete
34113300-5-Fuoristrada
34114400-3-Minibus
34111200-0-Vetura

VLERA E FONDIT LIMIT: 147,127,180 (njqind e dyzete e shtate milion e njqind e njezete e shtate mije e njqind e tetedhjetë) Leke PA TVSH.

LEK PA TVSH dhe 1,501,450.96 (Nje milion e pesqind e nje mije e katerqind e pesedhjetë pike nentedhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH

***Shenim :** Vlerat ne leke jane konvertuar ne monedhen euro me kursin zyrtar te kembimit te Bankes se Shqiperise me date 19.06.2025 me kurs kembimi 97.99 (nenetedhjetë e shtate pike nentedhjetë e nente) leke.

Loti 1- Blerje Automjesh /**Autoveture 4+1** fondi limit 90,216,000 (nentedhjetë milion e dyqind e gjashtembdhjetë mije)Leke pa TVSH ose 920,665.37 (Nenteqind e njezete mije e gjashteqind e gjashtedhjetë e pese pike tridhjetë e shtate) Euro pa TVSH *(Kursi i këmbimit sipas Bankës se Shqipërisë më datë 19.06.2025 është 97.99).*

Loti 2 -Blerje Automjetesh/SUV4+1 fondi limit 52,201,333 (Pesedhjetë e dy milion e dyqind e një mijë e treqind e tridhjetë e tre)leke Pa TVSH ose Eur 532,721.03 (Peseqind e tridhjetë e dy mijë e shtateqind e njetzet e një pike zero tre) Euro pa TVSH, *Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më datë 19.06.2025 është 97.99).*

Loti 3- Blerje automjetesh/**Minibus** 15+1 Fondi limit 4,709,847 (Kater milion e shtateqind e nente mijë e teteqind e dyzet e shtate) Leke pa TVSH ose Euro 48,064.56 (Dyzete e tete mijë e gjashtedhjetë e kater pie pesedhjetë e gjashtë) Euro Pa Tvsh ,*Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më datë 19.06.2025 është 97.99).*

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, Ligji 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” nenit 21, pika 2, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria “Illyrian Guard” ShA.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në zbatim të Urdhërit të Prokurimit Nr. Prot 766 ,datë 17.06.2025, të Administratorit, është ngritur Njësia e Prokurimit për hartimin e kriterëve të veçanta për procedurën me objekt: “Blerje Automjetesh ” **Për nevojat e Shoqerisë Illyrian Guard SH.A.**

Në mbështetje të termave të references dhe fondit limit propozojmë kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto

kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 OE duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku

vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure si dhe nenin 77, pika 3, të LPP (i ndryshuar), si dhe nenin 43, pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar. Kjo procedurë është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara si dhe është përcaktuar në atë masë / vlerë që të ruajë një balancë midis nxitjes së pjesëmarrjes dhe rritjes së konkurrencës si dhe nevojës që AK ka për tu siguruar që ofertuesit zotërojnë kapacitet e nevojshme në funksion të realizimit të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Kjo procedurë është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të balanceve vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare 2022, 2023 dhe 2024, të konfirmuara nga autoritetet përkatëse tatimore, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 "Per Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenit 40/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të

vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si: referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2. Autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikat 6 dhe 8, të nenit 40, të Rregullave të Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave objekt kontrate, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet e kërkuara.

Konkretisht kjo kërkesë është vendosur :

1. për të rritur sigurinë dhe bindjen e AK se ofertuesit janë të aftë të realizojnë kontratën në rast se shpallen fitues si dhe
2. për të garantuar AK se oferta teknike është e bazuar në produkte reale të identifikuar nga ofertuesit.

Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së ofertuesve për përmbushjen me sukses të kontratës.

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se, ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit, si dhe për të garantuar AK se oferta teknike është e bazuar në produkte reale të identifikuar nga ofertuesit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë

së OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë jep garanci më tepër për:

- Përfshirjen dhe suportin e prodhuesit, përmes rishitësit/partnerit të autorizuar.
- Vazhdimësinë dhe jetëgjatësinë e produktit
- Përmes regjistrimit të të dhënave të prodhuesit, përftimin e mëvonshëm potencial të suportit nga ana e tyre.

Gjithashtu, ky dokument siguron AK se:

a- Operatori ekonomik ka leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në tregun e Shqipërisë dhe se janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto mjete.

b- Nëpërmjet informacionit të plotë të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktojë me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se, çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të kërkojë garanci mbi cilësinë e artikujve të sipërcituar, të njohë kapacitetet tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve.

Në përfundim, vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është e arsyeshme dhe e nevojshme për garantimin e cilësisë, autorizimit dhe transparencës në këtë proces.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila të jetë e shoqëruar me certifikatën e konformitetit (CoC)/ekuivalent të leshuar nga prodhuesi.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Sipas Ligjit Nr. 162/2020 për prokurimin publik, specifikimet teknike dhe kriteret e pranueshmërisë duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe të jenë proporcionale. Në kuadër të procedurës së prokurimit për blerjen e automjeteve, kërkesa për paraqitjen e Certifikatës së Konformitetit (COC) është një element i domosdoshëm për të garantuar që automjetet që do të furnizohen janë në përputhje të plotë me standardet teknike dhe rregulloret ligjore në fuqi, si në nivel kombëtar ashtu edhe atë evropian. Arsytet për këtë kërkesë janë si më poshtë: Përputhshmëri me standardet e sigurisë dhe mjedisit, COC është dokumenti që dëshmon se automjeti i ri është prodhuar në përputhje me direktivat dhe standardet e Bashkimit Evropian, përfshirë normat e emetimit të gazrave (p.sh., Euro 6), kërkesat për frenimin, ndriçimin, mbrojtjen e këmbësorëve, etj. Verifikimi i specifikimeve teknike, COC përmban të dhëna të detajuara për çdo aspekt teknik të automjetit (peshën, fuqinë motorike, përmasat, emetimet, konsumin e karburantit, etj.), duke

mundësuar autoritetit kontraktor të verifikojë përputhshmërinë me kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Garancia për origjinalitet dhe standardizim, COC lëshohet vetëm nga prodhuesi i tij për automjete të reja dhe të standardizuara.

Kërkesa për COC rrit nivelin e kontrollit teknik dhe dokumentar, duke forcuar integritetin e procedurës së prokurimit dhe duke garantuar që fondet publike përdoren për blerje që përmbushin standardet më të larta të cilësisë dhe sigurisë.

2.3.4. Mjetet duhet të jenë prodhim minimum i 2 (dy) viteve të fundit , ≥ 2024 të cilat duhet të jenë të reja me kilometrazh zero.

Argumentim : Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Sipas Ligjit Nr. 162/2020 për prokurimin publik, specifikimet teknike dhe kriteret e pranueshmërisë duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe të jenë proporcionale. Kërkesa që mjetet të jenë prodhim i dy viteve të fundit siguron përdorimin e teknologjive moderne dhe të përputhshme me standardet aktuale, pa e kufizuar konkurrencën në mënyrë të padrejtë.

Kërkesa që mjetet të jenë prodhim i dy viteve të fundit siguron përdorimin e teknologjive moderne dhe të përputhshme me standardet aktuale, pa e kufizuar konkurrencën në mënyrë të padrejtë.

Përdorimi i teknologjisë së fundit: Mjetet prodhim i dy viteve të fundit përfshijnë risitë teknologjike më të fundit, të cilat sjellin përfitime në: Efikasitet energjetik (konsumi i ulët i karburantit), Eficiencë operationale dhe performancë, Siguri më të lartë në përdorim, Përputhshmëri me normat e reja mjedisore dhe teknike (p.sh. Euro 6).

2.3.5. Deklaratë garancie për mjetet e ofruara (autoveturat 4+1 dhe 15+1), ku të jetë përcaktuar periudha e garancisë jo më pak se 5 vite ose jo më pak se 150,000 km (Garancia të jetë e shoqëruar me një deklaratë për normën që do të kryhen shërbimet profilaktike dhe zërave të shërbimeve).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter vendoset për të garantuar përmbushjen e detyrimeve nga operatori ekonomik në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Kërkesa për një **garanci minimale 5-vjeçare** është një masë e bazuar teknikisht, që siguron mbrojtje të mjaftueshme për autoritetin kontraktor dhe reflekton praktikën e tregut dhe jetëgjatësinë e parashikuar të mjeteve. **Garancia e zgjatur** nxit ofruesit të sigurojnë pajisje me cilësi më të lartë dhe shërbim më të mirë teknik gjatë gjithë ciklit të përdorimit. **standardet aktuale të prodhuesve ndërkombëtarë** tregojnë se një periudhë 5-vjeçare është tashmë praktikë normale për mjete cilësore dhe nuk përbën kërkesë të jashtëzakonshme.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që ka servis të specializuar dhe garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e mjeteve objekt i prokurimit, gjatë periudhës së garancisë, në servisën e tij / një servisi të marrë me qera, apo përmes një servisi me të cilin mund të ketë të lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, dhe të specifikojë adresën e servisit dhe me foto të brendshme e të jashtme të ambjenteve të servisit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, neni 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter vendoset për të garantuar përmbushjen e detyrimeve nga operatori ekonomik në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Operatori ekonomik disponon servisin e specializuar me infrastrukturë dhe staf të trajnuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e autoveturave objekt i prokurimit. Ai garanton realizimin e shërbimeve gjatë periudhës së garancisë në servisin e vet, në servisin e marrë me qera, ose përmes serviseve të certifikuara me të cilët ka kontrata bashkëpunimi të vlefshme. Kjo siguron shërbim të shpejtë, cilësor dhe në përputhje me manualet dhe standardet teknike të prodhuesit, duke garantuar funksionimin optimal dhe jetëgjatësinë e mjeteve.

2.3.7. Deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjetit të targuar dhe regjistruar në pronësi të AK, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë (zhdoganimin, regjistrimin, targimin me targa shqiptare, siguracion TPL).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, neni 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter vendoset për të garantuar përmbushjen e detyrimeve nga operatori ekonomik në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Dorëzimi i mjetit të targuar dhe regjistruar në pronësi të Autoritetit Kontraktues, me përfshirjen e të gjithë dokumentacionit ligjor dhe teknik, garanton përdorimin e menjëhershëm dhe të ligjshëm të automjetit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Operatori ekonomik siguron zhdoganimin, regjistrimin, targimin me targa shqiptare dhe siguracionin detyrues Civil (TPL), duke përmbushur të gjitha kërkesat administrative dhe ligjore që janë kusht për qarkullimin e automjeteve. Ky proces i plotë tekniko-administrativ minimizon rreziqet e vonesave apo problemeve ligjore dhe ofron siguri maksimale për Autoritetin Kontraktues, duke siguruar funksionimin e pandërprerë dhe përdorimin e ligjshëm të mjeteve të furnizuara.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi ku të tregohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të artikujve të ofertuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, për artikujt/produktet që oferton. Paraqitja e katalogut ose skedës teknike nga prodhuesi siguron transparencë dhe verifikim të plotë të karakteristikave teknike të mjeteve të ofruara. Ky dokumentacion është thelbësor për të vërtetuar që mjetet janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e

kërkuara në tender, duke shmangur ofrimin e produkteve jo të përshtatshme. Lehtësuar procesin e krahasimit teknik midis ofertave të ndryshme, duke mundësuar një vlerësim objektiv dhe të drejtë. Siguruar që teknologjia dhe performanca e mjeteve të përmbushin kërkesat funksionale dhe cilësore të nevojshme për përdorimin efektiv dhe të qëndrueshëm. Përforcuar besueshmërinë dhe sigurinë në realizimin e kontratës. Në këtë mënyrë, kërkesa për katalog ose skedë teknike është një mjet kyç për garantimin e cilësisë dhe pajtueshmërisë së produkteve të ofruara në procesin e prokurimit.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër se koha per kryerjen e sherbimeve profilaktike(vaj, filtra, set), do të jetë brenda 48 orëve nga paraqitja e mjetit prane servisit.

Argumentim: Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do t'i përgjigjet kërkesave të AK per kryerjen e sherbimeve profilaktike(vaj filtra set), me qëllim përmbushjen e misionit atë të ofrimit të shërbimit të Autoriteti Kontraktor, dhe në mbështetje të nenit 77, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public.

Shënim: E gjithë flota duhet të jetë e një marke

Operatori ekonomik i cili oferton në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare si dhe kapacitetet teknike, sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njesia e prokurimit